



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 273/3 Prot

Tiranë, më 27.3.2025

V E N D I M

Nr.10, datë 27.3.2025

“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Dimal dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës.”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në institucionin e Bashkia Dimal,

VËREJ SE:

Me urdhërin nr. 124 (945 prot.), datë 20.12.2024, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Dimal”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 945/1 Prot., datë 20.12.2024, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Dimal me shkresën nr. 945/2 Prot., datë 20.12.2024, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Dimal”.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Dimal, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 273 prot., datë 26.02.2025, të Komisionerit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, e ka dërguar materialin pranë Komisionerit të nënshkruar, pa observacione, me shkresën nr. 720 prot., datë 28.02.2025 si dhe ka paraqitur disa sqarime nëpërmjet shkresës nr. 720/1 prot., datë 07.03.2025 *“Informacion shkresës nr. 720 prot., datë 28.02.2025”*.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri vlerësoi si të rëndësishme, për të dhënë disa orientime në lidhje me procesin e ndërtimit të strukturës dhe organigramës së institucionit, duke e analizuar në mënyrë të hollësishme skemën e strukturës dhe në përfundim ka lënë detyra konkrete në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, bazuar në Udhëzuesit e Komisionerit:

- nr.1082 prot., datë 14.12.2021 *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022”*;
- nr. 654, datë 02.10.2024, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit”*,

të cilët janë akte rregullative, që kanë dalë për të siguruar aplikimin e standardeve më të mira në ndërtimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në njësitë e vetqeverisjes vendore, nëpërmjet një vlerësimi real të pozicioneve të punës që e përbëjnë aktualisht skemën e administrimit të shërbimit civil, në referencë të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim që të përcaktohet me saktësi raporti i tyre me shërbimin civil, e për pasojë një strukturë ekonomike, eficiente dhe efektive.

E rëndësishme është të theksohet gadishmëria e institucionit, për të zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri në Udhëzimin e përmendur më sipër, në drejtim të ngritjes së Komitetit të Vlerësimit të Pozicioneve të Shërbimit Civil, si dhe për njoftimin e subjekteve që janë pjesë e procesit të

rishikimit të përshkrimeve të punës (*aktet që materializojnë këto veprime janë administruar nga Komisioneri*), por nga ana tjetër, ende nuk janë arritur rezultate konkrete në lidhje me këtë proces. Për këtë arsye Komisioneri e vlerëson të rëndësishëm finalizimin e procesit të vlerësimit të pozicioneve të punës dhe më tej ndërtimin e strukturës sipas orientimeve konkrete që janë pasqyruar edhe në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Konstatohet se nga ana e institucionit, në përgjithësi, janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet institutit të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, ndërkohë që janë evidentuar edhe mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat janë vënë në dukje si konstatime në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- Në planin vjetor nuk janë pasqyruar **a)**nevojat për rekrutim të cilat janë krijuar gjatë vitit, si edhe **b)**nuk është evidentuar numri dhe pozicioni konkret për nivelin e ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, që mund të plotësohet edhe me kandidatë të tjerë që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioneri vlerëson se, nga njëra anë duhet treguar kujdes që pozicionet e lira të cilat janë të paplanifikuara, por që krijohen gjatë vitit kalendarik si rrjedhojë e aplikimit të instituteve të tjera të ligjit, të pasqyrohen si ndryshime të aktit administrativ që materializon planin e rekrutimit dhe nga ana tjetër të pasqyrojë qartë, në aktin përkatës numrin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, si dhe të nivelit të lartë drejtues, të cilat do të plotësohen me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke respektuar kufijtë ligjor numerik të lejuar.

- Janë konstatuar mangësi në procedurën dhe përmbajtjen e proceseve administrative të kryera gjatë rekrutimit, të materializuara në aktet administrative që kanë dalë në përfundim të tyre, te tilla si:

a) në të gjitha shpalljet e publikuara, në faqen e parë është evidentuar shënimi: “*Shpallje vetëm për nëpunës civil për procedurën e konkurimit kombëtar*”, në një kohë kur referuar pikës 8 të VKM nr. 243, datë 18.03.2025 **duhet**: “*shpallja e procedurës së pranimit në shërbimin civil*”;

b) mungon fusha kryesore mbi të cilën do të realizohet konkurrimi si dhe publikimi **nuk është bërë për grup pozicionesh**, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta;

c)në përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP), janë evidentuar ekspertë të fushës, të cilët rezultojnë të jenë të njëjtë për të gjitha procedurat e konkurimit, pranim në shërbimin civil dhe ngritje në detyrë, pavarësisht fushës së kompetencave që duhet të vlerësojnë, njëkohësisht KPP është ngritur rast pas rasti dhe jo i përhershëm;

c) njësia përgjegjëse, në funksion të procedurës duhet **të ftojë fituesin** që të japë miratimin/ose jo, për pozicionin për të cilin ka konkurruar që më pas, të dalë akti i emërimit;

d) e rëndësishme është që në dosjet personale të protokollohen kërkesat për aplikim.

- Konstatohen parregullsi në përmbylljen e periudhës së provës:

a) në të gjitha rastet, rezulton se nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër në detyrë dhe, si rezultat, mungon mendimi me shkrim i tij;

b) në këtë fazë të procesit, njësia përgjegjëse ka vepruar në kapërcim të kompetencave në disa raste, duke vepruar në rolin e eprorit direkt në nxjerrjen e aktit të konfirmimit të nëpunësve civilë në periudhë prove;

c) në formularin e vlerësimit vjetor të punës, të nëpunësit civil në periudhë prove, mungojnë komentet e zyrtarit raportues, të cilat janë element i nevojshëm për të vlerësuar objektivitetin e zyrtarit në përcaktimin e nivelit të vlerësimit të rezultateve në punë gjatë kësaj periudhe;

d) në aktet e vlerësimit të punës, nuk janë plotësuar në mënyrë të saktë dhe të qartë të gjitha të dhënat që kërkohen në ndarjet e formularit dhe ku të jenë nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e vlerësimit dhe nëpunësi i vlerësuar.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara më sipër, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë me korrektesë të gjitha kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbylljen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Dimal, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
2. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, subjektet e ngarkuara prej ligjit, ndër të cilat Komiteti i Vlerësimit, analisti i punës, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt për pozicionet e vlerësuara, duhet të finalizojnë procesin e nisur për vlerësimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbajtje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit dhe përshkrimet e rishikuara të punës, duhet të dërgohen pranë Komisionerit në përfundim të afatit të paralajmërimit.

3. Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, duhet të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë, (*relacion apo memo*) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.
4. Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.
5. Pasi të kryhen të gjitha detyrat që janë lënë në pikat 2; 3 dhe 4 të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Dimal, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil dhe të rregullojë pasojat, duke i shpallur pozicionet e lira pranë AKPA-së, për tu plotësuar në përputhje me ligjin. Në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrit, pozicioni duhet të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimit në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i

shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:

- **Rajmonda Shuka**, emëruar në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”, me aktin nr. 1017/5 prot, datë 15.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- **Esmeralda Burqu**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Financës*”, Drejtorinë e Ekonomisë dhe, Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, me aktin nr. 2644/1 prot, datë 11.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Melinda Bibo**, është emëruar në pozicionin “*Specialist për Ndihmën Ekonomike dhe PAK*”, në Drejtorinë e Shërbimit Social, Ndihmës Ekonomike, PAK, Qendrës Komunitare dhe Mbrotjtjes së Fëmijës, me aktin nr. 769 datë 01.12.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
- **Anila Kala**, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë për Zhvillimin e Projekteve dhe Integrimin European*”, me aktin nr. 821 datë 01.11.2024 të Kryetarit të Bashkisë
- **Misir Çela** emëruar në pozicionin “*Specialist i Statistikave*”, Drejtorinë për Zhvillimin e Projekteve dhe Integrimin European” me aktin nr. 526, prot, datë 11.07.2024, të Kryetarit të Bashkisë;
- **Igrid Shkëmbi**, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike*”, me aktin nr. 583 datë 5.09.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
- **Isi Shehu**, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve*”, me aktin nr. 1017/7 prot, datë 15.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë,
- **Pjerin Tumani**, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, me aktin nr. 732 prot, datë 23.09.2024, të Kryetarit të Bashkisë.

Të përfundojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësit e mëposhtëm, për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie:

- **Qazim Malasi**, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Auditit të Brendshëm*”, me aktin nr. 817 datë 22.12.2023, të Kryetarit të Bashkisë;
- **Marie Bizdani**, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë Ekonomisë dhe, Financës dhe Menaxhimit të Aseteve*”, me aktin nr. 317/15 prot, datë 15.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë;
- **Qazime Tumani**, emëruar në pozicionin “*Specialist Finance*”, Drejtorinë e Ekonomisë dhe, Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, me aktin nr. 632 prot, datë 12.08.2024, të Kryetarit të Bashkisë;

6. Për rregullimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në përmbyllje të periudhës së provës duhet që njësia përgjegjëse të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit për punonjësit të cilët kanë përfunduar periudhën e provës, për të cilët ka dalë akti i konfirmimit si nëpunës civil nga eprori direkt (*bëhet fjalë për nëpunësit D. Sofka, A. Gjoni, P. Tomasi, Y. Asnaj, E. Lushka, S. Muhametani, M. Alollari, A. Mimani, M. Barjamaj*).

Ndërsa, në lidhje me nëpunësit e emëruar në peridhë prove, që ende nuk e kanë plotësuar afatin 1 vjeçar, të korrigjohen aktet e emërimit të nxjerra nga njësia përgjegjëse në momentin e emërimit të nëpunësit civil, nga “*emërohen në pozicionin.....*”, në “*emërohen si nëpunës civil në periudhë prove*”, në *pozicionin.....*”, për 5 nëpunësit që janë aktualisht në periudhë prove, të cilët evidentohen në vijim:

- Mateo Plaku, emëruar me aktin nr. 471/24 prot., datë 15.04.2024, në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, Shërbimeve Mbështetëse, Marrëdhënieve me Publikun dhe Ndihmën Ekonomike;
- Pranvera Lleshi, emëruar me aktin nr. 637/25 prot., datë 05.08.2024 në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e marrëdhënieve me publikun, komunikim me median dhe çështjet e diasporës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, Shërbimeve Mbështetëse, Marrëdhënieve me Publikun dhe Ndihmën Ekonomike;
- Kejdi Mimani, emëruar me aktin nr. 470/24 prot., datë 12.04.2024 në pozicionin, “*Specialist bujqësie*”, në Sektorin e bujqësisë në Drejtorinë e Asistencës së Fermerit, Mjedisit, Pyjeve dhe Mbrojtjes Konsumatore;
- Fatjona Gjoshi, emëruar me aktin nr. prot., datë 05.08.2024 në pozicionin, “*Inspektor për menaxhimin e aseteve*”, në Sektorin e financës, në Drejtorinë e Ekonomisë, Financës dhe Menaxhimit të Aseteve;
- Majlinda Dhimo, emëruar me aktin nr. 1636/23 prot., datë 05.08.2024 në pozicionin, “*Specialist për sistemin gjeoinformatikë*”, në Sektorin për strehimin, hartimin e projekteve, lejet e ndërtimit, kontrollin e projekteve, ndjekjen e kontratave dhe monitorimin e investimeve në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Strehimit, Hartimit të Projekteve dhe Emergjencave Civile.

7. Njësia Përgjegjëse të verifikojë diplomat në lidhje me kreditet e nevojshme në përputhje me aktin nënligjor përkatës, për nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, për punonjësit:

- o Redina Malasi, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Strehimit, Hartimin e Projekteve, Lejet e Ndërtimit, Kontrollin e Projekteve, Ndjekjen e Kontratave dhe Monitorimin e Investimeve në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Strehimit, Hartimit të Projekteve dhe Emergjencave Civile;
- o Brunilda Guraj, emëruar në pozicionin *Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Borxhit;

- Rabushe Hoxha, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, Shërbimeve Mbështetëse, Marrëdhënieve me Publikun dhe Ndihmën Ekonomike;
 - Marinela Stavri, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e marrëdhënieve me publikun, komunikim me median dhe çështjet e diasporës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, Shërbimeve Mbështetëse, Marrëdhënieve me Publikun dhe Ndihmën Ekonomike
8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Dimal, Prefekti i Qarkut Dimal, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Dimal, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha